



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PORTI DETAR SHA SARANDË
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr.409/9. Prot.

Sarandë, më.15.08.2024

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Mbulimi me kamera i territorit të Portit Detar SHA Sarandë, përfshirë terminalin, zyrat e administratës dhe kalatat”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

35125300-2 - Kamera sigurie, 32350000-1 - Aksesori të paisjeve audio dhe video, 32421000-0 - Kabllorjet, 33195100-4 - monitor, 44523200-4 - montime.

PROCEDURA : "E hapur e thjeshtuar" Mall, (elektronikë).

BURIMI: Vetëfinancim

AFATI : 45 (dyzet e pesë) ditë, nga nënshkrimi i kontratës.

REFERENCA : Programi Ekonomik i Shoqërisë për vitin 2024

Urdhër Prokurimi Nr.17 datë 30.07.2024

VLERA E FONDIT LIMIT: 2.998.641 (dy milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e dyzet e një) Lek pa TVSH.

Përllogaritja e fondit limit, specifikime teknike: Sipas Projekt, Specifikime teknike dhe Preventivit të paraqitur nga: Ing. Altion Memushi Nr. Liç E1202/1.

KODI OUTPUT: 0000000

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” I ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Porti Detar Sha Sarandë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

b. Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Sigurimi i Ofertës: Në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, Neni 83: Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës. Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është 2% e fondit limit pa TVSH: **59 973** (pesëdhjetë e nëntë mijë e nëntë qind e shtatëdhjetë e tre) lekë pa tvsh.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

c. *Formulari i ofertës sipas Shtojcës 1 dhe Shtojcës 2;*

Argumentimi: Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik" I ndryshuar dhe të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, çdo operator ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë pjesë të ofertës së tij edhe formularin e ofertës sipas Shtojcës 1 dhe Shtojcës 2 të Dokumenteve Standarte të Tenderit.

d. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.8 (Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit). Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë përpara nënshkrimit të kontratës dokumentin e deklaruar ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Njësia e Prokurimit e ka hartuar këtë kriter duke u bazuar në pikën 7, gërma "a", neni 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, për të provuar se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik.

a) Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale.

b) Të jetë i specifikuar në QKB objekti i veprimtarisë së operatorit ekonomik i njëjtë ose ekuivalent me objektin e prokurimit.

Sipas përcaktimeve të bëra në Shtojcën 7 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit**).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, nenin 40 pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiros vjetore për tre vitet e fundit financiare (2021,2022 dhe 2023), ku vlera e xhiros për të paktën njërin nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë **jo më e vogël se 40%** e vlerës së parashikuar të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke qenë se lloji i procedurës është “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 2, gërma “c” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:..... b) 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar.....”;

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2024 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2022 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në

përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj. Duke qenë se autoriteti kontraktor është njësi e autoriteteve vendore e gjen të arsyeshme që pjesmarrjen e operatorëve ekonomikë ofertues në këtë procedurë prokurimi ta kushtëzojë me shlyerjen në kohë të taksave vendore të parashikuara me ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat (furnizimet) e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate, për furnizime të ngjashme të kryera tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues për realizimin e kontratës duhet të ketë të punësuar dhe të figurojnë në listëpagesën e subjektit për periudhën Prill 2024 - Qershor 2024 dhe në vazhdim, specialistët si më poshtë:

- Minimumi 1 (një) Inxhinier: Elektrik ose Elektronik.
- Duhet të disponojë fuqi punëtore **minimalisht** 15 punonjës, me qëllim realizimin e kontratës.

Për të provuar kriteret e mësipërme operatori ekonomik duhet të parasë:

- ✧ Diplomë përkatëse për inxhinierin.
- ✧ Kontratë pune e vlefshme.

Për fuqinë punëtore për periudhën Prill 2024 - Qershor 2024 dhe në vazhdim, të vërtetuar me dokumentacionin si vijon;:

- ✧ Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën Prill 2024 - Qershor 2024.
- ✧ Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Prill 2024 - Qershor 2024 .

Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësin/punonjësit e sipërcituar emrin dhe profilin e punës .

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me VKM nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Licenca profesionale e operatorit ekonomik ofertues lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- NS - 13 A Impiante dhe linja telefonike dhe telekomunikacioni.
- NS - 14 A Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

Argumentimi 2.3.2 dhe 2.3.3 : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”i ndryshuar si dhe nenit 40, pika 5-b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të garantojnë që zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Referuar natyrës së punimeve që kërkohen të prokurohen siç janë punimet për implementimin e një sistemi multifunksional teknologjik që do të mundësojë krijimin e infrastruktures se nevojshme per sistemin e monitorimit nëpërmjet kamerave të sigurisë është e nevojshme pasja e një stafi teknik të kualifikuar, për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa për inxhinierin elektrik ose elektronik është e diktuar nga natyra dhe e punimeve që do të kryhen për instalimin dhe konfigurimin e këtij sistemi. Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit të prokurimit. Është kërkuar minimimi një inxhinier, elektrik ose elektronik për zbatimin e aspekteve teknike në përputhje me zërat e pasqyruara në preventiv dhe specifikimeve teknike që do të zbatohen dhe si dhe kategorive përkatëse në licencën përkatëse të zbatimit. Inxhinieri elektrik ose elektronik është përgjegjës për zbatimin e saktë të preventivit për secilin nga zërat e punimeve që ka lidhje të drejtpërdrejtë me njohuritë e tij profesionale dhe për cilësinë e materialeve që vendosen. Duke patur parasysh sistemin që do të instalohet,

numrin e pajisjeve dhe kohën në dispozicion nga projektuesi është diktuar numri më shumë se një inxhinieri, si minimumi i nevojshem për të siguruar ecurinë e procesit.

Argumentimi për numrin minimal prej 15 punonjësish:

Kërkesa për një numër minimal prej 15 punonjësish është vendosur për të siguruar që operatori ekonomik ka burimet njerëzore të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet e projektit brenda afatit të përcaktuar prej 45 ditësh. Numri 15 është konsideruar i përshtatshëm sepse siguron ndarjen e detyrave në mënyrë të tillë që të shmanget mbingarkesa për individët dhe të garantohet se çdo fazë e projektit do të përmbushet në kohë dhe me cilësi të lartë.

Ky projekt është veçanërisht sfidues për shkak të lartësive ku do të montohen pajisjet, largësive të mëdha që duhet të mbulohen përmes shtrimit të fibrave optike, kablove dhe tubave, si dhe gjetjes së rrugëzimeve të përshtatshme për kalimin e tyre. Këto kushte kërkojnë një ekip të madh dhe të kualifikuar që mund të përballojë vështirësitë teknike dhe logjistike që do të hasen gjatë realizimit të projektit.

Argumentimi për minimumi një inxhinier elektronik ose elektrik:

Prania e të paktën një inxhinieri elektronik ose elektrik është e domosdoshme për sigurinë dhe cilësinë e projektit. Inxhinieri do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen teknike të projektit, duke përfshirë instalimin e pajisjeve, konfigurimin e sistemeve, dhe sigurimin që të gjitha pajisjet të funksionojnë siç duhet sipas specifikimeve teknike. Për më tepër, duke marrë parasysh natyrën sfiduese të projektit – përfshirë punën në lartësi, shtrimin e kablove dhe tubave në distanca të mëdha dhe në kushte të vështira – inxhinieri do të luajë një rol kritik në planifikimin dhe ekzekutimin e sigurt dhe efikas të këtyre detyrave.

Ndarja e punës dhe shpërndarja e stafit gjatë periudhës 45-ditore

Për të përmbushur afatin 45-ditor, puna do të ndahet në faza specifike, me një numër të caktuar punonjësish të caktuar për secilën fazë. Më poshtë është një ndarje e punës:

1. Faza e Planifikimit (5 ditë):

- 2 punonjës të ngarkuar me planifikimin dhe koordinimin e përgjithshëm të projektit, duke përfshirë inxhinierin.
- 1 punonjës për logjistikën dhe përgatitjen e materialeve.

2. Faza e Montimit (15 ditë):

- 6 teknikienë për montimin e pajisjeve CCTV, kablove dhe pajisjeve të tjera të infrastrukturës, duke përfshirë punën në lartësi dhe instalimin e tubave.
- 2 punonjës për vendosjen dhe lidhjen e pajisjeve, nën mbikëqyrjen e inxhinierit, duke siguruar që shtrimi i fibrave dhe kablove të bëhet në përputhje me standardet teknike dhe të sigurisë.
- 1 punonjës për menaxhimin dhe koordinimin e punëve të montimit, duke mbikëqyrur përparimin dhe duke raportuar për çdo problem të mundshëm.

3. Faza e Konfigurimit (10 ditë):

- 4 teknike për konfigurimin e sistemeve, duke përfshirë sistemin CCTV, aksesin e kontrollit, dhe pajisjet e tjera.
- 1 inxhinier për të mbikëqyrur procesin e konfigurimit dhe për të siguruar që të gjitha pajisjet funksionojnë në mënyrë optimale.

4. Faza e Integritit dhe Testimit (10 ditë):

- 3 teknike për integrimin e sistemeve të ndryshme në një platformë të vetme dhe për testimin e funksionalitetit të tyre.
- 1 inxhinier për të siguruar që integrimi të bëhet sipas standardeve teknike dhe për të menaxhuar çdo problem që mund të lindë gjatë testimit.

5. Faza e Trajnimit dhe Dorëzimit (5 ditë):

- 2 punonjës për trajnimin e stafit të klientit në përdorimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve.
- 1 inxhinier për të siguruar që stafi i klientit kupton të gjitha aspektet teknike të sistemeve dhe për të dorëzuar projektin në mënyrë të suksesshme.

Kjo ndarje e punës siguron që çdo fazë e projektit të trajtohet në mënyrë efektive dhe brenda afatit të përcaktuar. Me një ekip të dedikuar për çdo fazë dhe me një inxhinier që mbikëqyr procesin teknik, projekti ka një mundësi të lartë për të përfunduar me sukses dhe për të përmbushur të gjitha kërkesat e kontratës, pavarësisht nga vështirësitë që paraqesin lartësitë, largësitë, dhe shtrimi i infrastrukturës.

Me anë kriterit 2.3.3 kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente. Licencat janë të lidhura ngushtësisht me zërat e punimeve të pasqyruara në preventiv. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

2.3.4 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik për mallrat e ofruara, si më poshtë :

Nr.	Emërtimi
1	Kamera të brendshme Dome 6MP
2	Kamera të brendshme Dome 8MP
3	Kamera e jashtme ANPR (Lexues Targe)
4	Kamera PTZ e jashtme 4MP 25x
5	Paisje Regjistruese NVR/Server 64 Kanale
6	Switch 8 Ch POE + 2SPF I menaxhueshëm
7	Switch 8 Ch POE + 2SPF industrial
8	Software Menaxhimi

Tabela 1

duhet të paraqesë: Katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve të lëshuara ose publikuara nga prodhuesit/distributorët zyrtarë ose skedat teknike të lëshuara ose publikuara nga prodhuesit/distributorët zyrtarë, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Në katalogun ose skedën teknike duhet të jetë specifikuar produkti që është paraqitur në ofertë dhe specifikimet teknike, ku të gjëjmë pasqyrim për parametrat teknikë të produktit (të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar, përveç elementëve teknik specifik, termave në anglisht që përdoren ndërkombëtarisht, që janë vendosur në specifikimet teknike (shih specifikimet teknike në projekt), me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse mallrat e ofruara plotësojnë kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Argumentimi: Në bazë të nenit , të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” I ndryshuar dhe nenit 40, pika 6-b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendorsja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave të cilat janë të domosdoshme në realizimin e punimeve objekt prokurimi. Në këtë rast është shumë e rëndësishme si dëshmi për plotësimin e kërkesave dhe specifikimeve teknike verifikimi i të dhënave të produktit në katalog për të garantuar cilësinë e kërkuar dhe funksionalitetin gjatë përdorimit të tyre.

2.3.5 Operatori/et ekonomik në rast se nuk janë prodhues duhet të paraqesin për shitjen e të gjitha produkteve të kërkuara në Tabelën 1, **vërtetim ose deklaratë ose autorizim nga prodhuesi, ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit**, vërtetuar me marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertuesit - distributor-prodhues, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: telefon, e-mail, website, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.(Nëse dokumentacioni është në gjuhë të huaj duhet e përkthyer dhe noterizuar si dëshmi e vërtetësisë dhe saktësisë së përkthimit)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 77 të LPP-së, si dhe nenit 40, pika 8 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Është gjykuar si kriter i domosdoshëm, pasi ka të bëjë me informacion e nevojshem se ku prodhohet malli dhe mundësinë reale për të bere furnizimin, nëpërmjet autorizimit që i jepet operatorit ekonomik ofertues.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një **deklarate të garancisë** për mallrat e ofruara, sipas përcaktimeve në Shtojcën Nr. 5- Specifikime teknike, nga marrja në dorëzim të mallrave objekt prokurimi, **të paktën 1 vit garanci** për çdo pajisje objekt prokurimi duke filluar nga marrja në dorëzim e mallit.

Mosdeklarimi si më sipër, përbën kusht për skualifikim.

2.3.7 Operatori ekonomik për mallrat e ofruar duhet të paraqesë një **deklaratë konformiteti** me standartet e Komuniteti European CE .

Mosdeklarimi si më sipër, përbën kusht për skualifikim.

Argumentimi 2.3.6, dhe 2.3.7: Kërkesat e mësipërme janë bazuar në nenin 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

Porti Detar SHA Sarandë ka për qëllim të sigurojë një nivel të lartë të sigurisë në territorin e saj nëpërmjet metodave të avancuara të raportimit dhe monitorimit të përshtatshëm. Objektivi kryesor është garantimi në shkallën më të lartë të sigurisë së qytetarëve dhe perfeksionimi i sistemit të mbikëqyrjes dhe garantimit të sigurisë në territorin e portit. Punonjësit e sigurisë do të kenë mundësinë e monitorimit në kohë reale të pikave kyce me kamera dhe të regjistrojnë pamjet filmike në një pajisje qendrore NVR. Bazuar në nevojat e punës janë përcaktuar pajisjet që janë të nevojshme të prokurohen, janë hartuar specifikimet teknike, skema e vendosjes të kamerave si dhe preventivi me artikujt përkatës.

Vendosja e këtyre kriterëve të kualifikimit, është pjesë e domosdoshme në funksion të realizimit me sukses të kontrates, pasi pajisjet do të montohen, implementohen në sistemet ekzistuese, do të provohen nëse i kryejnë funksionet sipas specifikimeve teknike, do të instalohen aplikacionet apo softweret përkatëse etj. Kjo e bën të domosdoshëm që operatori ekonomik të japë një garanci një vjeçare për pajisjet, produkti përputhet me kriteret themelore të Bashkimit Evropian dhe duhet të shoqërohet me anë të çertifikimit CE.

2.3.8 Operatori Ekonomik duhet të jetë i çertifikuar me ISO 9001:2015 (ose ekuivalente) mbi “**Sistemet e menaxhimit të cilësisë**”, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo çertifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë çertifikuar dhe të provohet garantimi i standardeve të kërkuara në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht mallra cilësore që plotësojnë kërkesat të AK-së dhe është i përkushtuar për përmirësimin e vazhdueshëm.

2.3.9 Operatori Ekonomik duhet të jetë i çertifikuar me ISO 27001:2022 (ose ekuivalente) për “**Menxhimin e Sigurisë së Informacioneve**”, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo çertifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë çertifikuar dhe të provohet garantimi i standardeve të kërkuara në sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të sigurisë së informacionit, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të mbrojtur informacionin e ndjeshëm nga rreziqet dhe kërcënimet.

2.3.10 Operatori Ekonomik duhet të jetë i çertifikuar me ISO IEC 20000-1:2018 (ose ekuivalente) për “**Menaxhimin e Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit**”, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", është kërkuar kjo çertifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë çertifikuar dhe të provohet garantimi i standardeve të kërkuara në sistemin e menaxhimit të shërbimeve të teknologjisë së informacionit. . Është kërkuar kjo çertifikatë pasi ofron një kuadër për menaxhimin e shërbimeve IT në mënyrë efektive, duke përfshirë instalimin dhe mirëmbajtjen e paisjeve dhe sistemeve.

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet: *"Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla"*, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: *"Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin..."*, **sjellim në vëmendje se:**

- Disponimi i dokumentave të kërkuara më sipër do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet t'i dërgojë kërkesë në rrugë elektronike (nëpërmjet sistemit të APP) ofertuesit të kualifikuar i pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njëhsuara me origjinalin.
- Mosparaqitja e dokumentacionit do të jetë kusht s'kualifikimi si dhe do të veprohet sipas nenit 83 pika 3 dhe 5 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik".
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimet e bëra gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke

argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimitisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën **28.08.2024, ora 10:00**.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt: **“Mbulimi me kamera i territorit të Portit Detar SHA Sarandë, përfshirë terminalin, zyrat e administratës dhe kalatat”**, Njësia e Prokurimit përcaktoi anëtarin e NJP znj.R.Ali.

Bashkëlidhur këtij proces-verbali:

- Dokumentat e tenderit
- Projekt dhe Specifikime Teknike .pdf
- Preventiv
- Skema e mbulimit me kamera .pdf

NJËSIA E PROKURIMIT